

RAPORT MBI AUDITIMIN

Auditimi është kryer nga: Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU)

Objekti i auditimit: Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe vlerësimin e veprimtarisë administrative e ekonomiko-financiare”.

Metoda e auditimit: Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje, bazuar në risqe, sipas cilësimeve të bëra në drejtimet vijuese.

Auditimi ka filluar më : 05.10.2016

Auditimi ka përfunduar më: 10.11.2016

Periudha e auditimit: 1.10.2015 deri më 30.09.2016

Drejtimit e angazhimit:

- A. Auditimi i procedurave të hartimit dhe zbatimit të buxhetit.
 - a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit.
 - b. Respektimi i disiplinës buxhetore.
- B. Zbatimi i dispozitave ligjore për mardhëniet e punës dhe të pagave.
 - a. Respektimi si strukturës organike të miratuar.
 - b. Respektimi i kuadrit ligjor në fuqi për trajtimin financiar të punonjësve sipas nivelit të pagave dhe shtesave mbi paga.
 - c. Auditimi i kontabilizimit dhe shlyerjen e detyrimeve për TAP, sig.shoq, sig.shend.
- C. Mbi administrimin e pronës publike.
 - a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera ndërmjet arkës.
 - b. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera ndërmjet bankës.
 - c. Saktësia dhe rregullariteti i veprimeve të kryera me anë të magazinës.
- D. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Mbi debi-kredi.
 - a. Organizimi i mbajtjes, azhurnimit, rregjistrimit kronologjik të transaksioneve në ditarë dhe librat e kontabilitetit
 - b. Analiza e gjendjes dhe dinamikave të debi-kredi. Rakordimi i logarive sintetike, analitike.
 - c. Inventarizimi i pronës shtetërore.
- E. Prokurimi i fondeve publike.
 - a. Llogaritja e fondit limit, zgjedhja e procedurave të prokurimit sipas kufinjëve monetarë.
 - b. Hartimi i dokumentacionit të prokurimit. Respektimi i afateve.
 - c. Zbatimi i kërkesave ligjore në lidhjen e kontratave dhe zbatimi i tyre.

- F. Vlersimi i sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe Manaxhimit Financiar.
 - a. Rregullorja e brendshme
 - b. Rregjistri i rreziqeve
 - c. Përshkrimi punës
 - d. Vlersimet vjetore dhe dosjet e personelit
 - e. Gjurma e auditit
 - f. Udhëzimit për manaxhimin financiar
- G. Përputhshmëritë ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- H. Të tjera, gjatë kontrollit.

Detyrat e lëna nga auditit:

- A. Të programohet puna për hartimin e Listës së Proceseve kryesore dhe Gjurmës së Auditimit.
- B. Të krijojë dhe përditësojë rregjistrin kontabël të aktiveve që ka në administrim.
- C. Të rregjistrojë në kartelat e magazinës, lëvizjet përkatëse të çdo artikulli, në sasi dhe vlerë.
- D. Të merren masa për tajnimin e punonjësve të institucioneve, të përfshira në procesin e dhënies së konformitetit për lejet zhvillimore të kërkuara.
- E. Të merren masa për plotësimin e vendeve të lira të punës, në përputhje me strukturën e miratuar nga Kryeministri, deri në finalizimin e këtij procesi.
- F. Të hartohen specifikimet teknike, në procedurat e prokurimit publik për mallra dhe shërbime, si dhe plotësimin e procesvlerbaleve (sipas formularit nr.5), të zbatohen kërkesat e Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, nr.3, datë 27.01.2015, “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, i ndryshuar.
- G. Të bëhen hyrje në magazinën e institucionit manuali për sistemimin e-leje në sasinë 70 copë.
- H. Në 37 aplikime të paraqitura , ose në 7% të totalit të aplikimeve për leje zhvillimi , aplikimi i kryer nga NJQV, Në RIT nuk është shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor .Në këto kusht AZHT e ka patur të pamundur të shprehet për aktin e konformitetit , brenda afateve ligjore
- I. Në 30 aplikime të paraqitura, ose në 6% të totalit të aplikimeve për leje zhvillimi, ndonëse NJQV kanë plotësuar dokumentacionin tekniko-ligjore në sistem (RIT), AKPT ka njoftuar AZHT jashtë afateve ligjore.
- J. Në 25 raste , ose në 5% të totalit të aplikimeve për leje zhvillimi, datat e përgjigjeve për konformitetin , në RIT, nuk përputhen me datat e shkresave të përgatitura nga Azht dhe përcjelljë AKPT-së , nëpërmjet sistemit.
- K. Në 25 raste , ose në 5% të totalit të aplikimeve për leje zhvillimi , AZHT ka përgatitur aktet e konformitetit , i ka dërguar për botim në RIT, por AKPT nuk i ka botuar ato.

Janë marr masa për realizimin e të gjithë detyrave të lëna nga auditi.